



Republika e Kosovës
Republika Kosova - Republic of Kosovo
Qeveria - Vlada - Government

Nr. 07/81
Datë: 23.03.2016

Qeveria e Republikës së Kosovës, në mbështetje të nenit 92 paragrafi 4. dhe të nenit 93 paragrafi (4) të Kushtetutës së Republikës së Kosovës, nenit 20 të Ligjit Nr. 03/L-087 për Ndërmarrjet Publike (GZ. Nr. 31/15 Qershor 2015), duke u bazuar në nenin 4 të Rregullores nr. 02/2011 për Fushat e Përgjegjësive Administrative të Zyrës së Kryeministrit dhe Ministrive, e ndryshuar dhe plotësuar me Rregulloren nr. 07/2011 dhe nenit 19 të Rregullores së Punës së Qeverisë së Republikës së Kosovës nr. 09/2011, në mbledhjen e mbajtur më 23 mars 2016, nxjerr këtë:

V E N D I M

1. Miratohen rregullat për lartësinë e kompensimit të anëtarëve të bordeve të Ndërmarrjeve Publike Qendrore sipas këtij kategorizimi:
 - 1.1. Kategoria I: Telekom i Kosovës, KEK, KOSTT, Posta e Kosovës;
 - 1.2. Kategoria II: Ibër Lepenc, Infracos, TrainKos, KRU Prishtina, Aeroporti i Gjakovës;
 - 1.3. Kategoria III: Ndërmarrjet tjera të sektorit të ujësjellësit, ujitjes dhe mbeturinave.
2. Kompensimi i anëtarëve të bordeve të Ndërmarrjeve Publike Qendrore bëhet sipas tabelës së bashkangjitur në shtojcën 1. të këtij vendimi.
3. Me hyrjen në fuqi të këtij vendimi, shfuqizohet vendimi Nr. 01/119 i datës 13.03.2013.
4. Vendimi hyn në fuqi ditën e nënshkrimit.

Isa MUSTAFA

Kryeministër i Republikës së Kosovës

Iu dërgohet:

- Zëvendëskryeministrave
- të gjitha ministrive (ministrave)
- Sekretarit të Përgjithshëm të ZKM-ës
- Arkivit të Qeverisë

Shtojca: Tabelat e niveleve të kompensimit për Bordet e Ndërmarrjeve Publike Qendrore

Tabela 1: Nivelet e kompensimit të anëtarëve të Bordeve sipas kategorisë

Kategoria	Pozita	Niveli i kompensimit
Kategoria 1	Kryesues	850
	Anëtar	600
Kategoria 2	Kryesues	650
	Anëtar	460
Kategoria 3	Kryesues	450
	Anëtar	320

Tabela 2: Nivelet e kompensimit të anëtarëve të Komiteteve të Auditimit sipas kategorisë

Kategoria	Pozita	Niveli i kompensimit
Kategoria 1	Kryesues	200
	Anëtar	150
Kategoria 2	Kryesues	155
	Anëtar	115
Kategoria 3	Kryesues	110
	Anëtar	80